

VENDIM
Nr. 82, datë 10.2.2021

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE
TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA
PROJEKTI “RIKONSTRUKSIONI I RRUGËS LALAR – MBYET”, NJËSIA
ADMINISTRATIVE PORTËZ, BASHKIA FIER**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti “Rikonstruksioni i rrugës Lalar – Mbyet”, Njësia Administrative Portëz, Bashkia Fier.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë Fier.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, në shumën e përgjithshme prej 570 818 (pesëqind e shtatëdhjetë mijë e tetëqind e tetëmbëdhjetë) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 570 818 (pesëqind e shtatëdhjetë mijë e tetëqind e tetëmbëdhjetë) lekësh, të përballohet nga buxheti i Bashkisë Fier.

5. Vlera për shpenzimet procedurale, në shumën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohet nga fondet e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.

6. Afati i përfundimit të shpronësimit të jetë brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

7. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, do të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin për likuidim, certifikatën e pronësisë, kartelën e pasurisë, si dhe hartën treguese të regjistrimit në zyrat e Bashkisë Fier.

8. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Fier, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Bashkinë Fier, të fillojnë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale të regjistrimit, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar dhe të bëjnë kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të Bashkisë Fier.

9. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Fier, të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin kur do të realizohet procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën treguese të regjistrimit.

10. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia Fier, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Fier dhe Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës pranë Këshillit të Qarkut Fier për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

Lista e pronarëve të pasurive, pronë private, që shpronësohen nga realizimi i projektit
Rikonstruksioni i rrugës “Lalar – Mbyet”, Njësia Administrative Portëz, Bashkia Fier

Vlerësimi i pasurisë së llojit “tokë arë”, është kryer bazuar në
VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016

Nr.	Emër Mbiemër	Lloji i pasurisë	Z.K.	Nr. i pasurisë	Sip. totale m ²	Sip. e shpronësuar m ²	Çmimi lekë/m ²	Vlera e tokës arë në lekë	Vlera totale në lekë	Adresa	Shënime
1	Teki Adem Bako	Tokë arë	2637	210	1900	742	269	199598	199,598	Njësia Administrative Portëz	Certifikatë pronësie
2	Bashkëpronarët Çepele, Shehaj, Lika, Hoxha, Bushaj	Tokë arë	2637	2248	2705	1380	269	371220	371,220	Njësia Administrative Portëz	Certifikatë pronësie
Vlera totale paraprake						2122		570818	570,818		